



Република Северна Македонија
Republika e Maqedonisë së Veriut

СУДСКИ СОВЕТ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА KËSHILLI GJYQËSOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Ул. "Македонија" бр.5, 1000 Скопје | тел.02/3218 130 факс.02/3218 131 | contact@ssrm.mk
Rr. "Makedonija" nr.5, 1000 Shkup | tel.02/3218 130 faksi.02/3218 131 | contact@ssrm.mk

Në bazë të nenit 44, paragrafi (1) dhe (2) të Ligjit të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr.102/19), Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut në seancën e mbajtur më 09.07.2020 miratoi

RREGULLORE PËR NDYSHIM DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR PUNË TË KËSHILLIT GJYQËSOR TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Neni 1

Në Rregulloren për punë të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr.274/19) titulli i nenit 7 dhe neni 7 ndryshohet dhe bëhet:

Regjistri gjyqësor për zgjedhje dhe evidentim të gjykatësve

(1) Personi përgjegjës për statistikën në këshill, vazhdimisht e përditëson Regjistrin gjyqësor, me të dhëna të detyrueshme sipas nenit 17 të Ligjit të Këshillit Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut (LKGJRMV, duke i regjistruar ato në evidencën e gjyqtarëve, në regjistrin gjyqësor (neni 14 paragrafi (1) pika (1) të rregullores), të aplikimit për zgjedhjen e gjyqtarit/kryetarit të gjykatës.

(2) Të dhënat për listën zgjedhore gjyqësore, janë marrë nga evidenca e gjyqtarëve në regjistrin gjyqësor.

(3) Evidentimi i gjyqtarëve duhet të përmbajë këto të dhënat:

- emri dhe mbiemri i gjyqtarit;
- numri amëzës;
- gjykata në të cilën kryen funksionin;
- data kur për herë të parë është zgjedhur si gjyqtar;
- nacionalitet;
- numri i legitimacionit të gjyqtarit dhe vendi për vërejtje.

Neni 2

Pas nenit 7, shtohet titulli dhe neni i ri 7-a, i cili thotë

Korrigjimet dhe ndryshim në evidentimin e gjyqtarve në regjistrin e gjykatësve dhe regjistrin gjyqësor zgjedhor

(1) Gjyqtari mundët në çdo kohë, deri në mbylljen e regjistrit gjyqësor zgjedhor, të kërkoj nga Këshilli Gjyqësor të dhëna në evidentimin e gjyqtarve dhe regjistrin gjyqësor zgjedhor përkatës, me dorëzimin e konfirmimeve dhe dëshmi për dorëzim të kërkuar.

(2) Me korrigjimin e të dhënave në evidencën e gjyqtarëve në regjistrin gjyqësor zgjedhor adekuat, nënkuptohet korrigjimi i emrave dhe numrave, si dhe gabimet e dukëshme dhe të pa sakta.

(3) Pas publikimit të shpalljes për zgjedhjen e anëtarit, këshilli në afat prej tre ditësh, e dorëzon në këqyrje regjistrin gjyqësor zgjedhor të të gjithë gjyqtarët.

(4) Këqyrja e Regjistrit gjyqësor zgjedhor zgjatë tri ditë

(3) Nëse bëhet fjalë për të dhëna të ndryshme thelbësore, gjyqtari mund në çdo kohë, me përjashtim të periudhës së ditës të publikimit të shpalljes për zgjedhjen e deri në ditën e mbarimit të shpalljesë, nga Këshilli Gjyqësor të kërkojë ndryshimin e të dhënave në evidentim të gjyqtarëve në regjistrin gjyqësor zgjedhor përkatës.

(4) Këshilli Gjyqësor në afat prej tre ditësh nga dita e pranimit të kërkesës, për dorëzim, gjegjësisht kërkesës për ndryshim e të dhënave dhe evidentimin e gjyqtarëve në regjistrin gjyqësor zgjedhor, përkatësisht, vendos me aktvendim.

(5) Kundër aktvendimit nga paragrafi (4) i këti neni, mundët të ndritet kontest administrativ deri te gjykata kompetente, në afat prej 24 orëve pas pranimit të aktvendimit

Neni 3

Në nenin 14, në paragrafin (1), pika (1) ndryshohet dhe bëhet:

(1) "Regjistri i gjyqtarëve" përditësimin e dosjeve elektronike të gjyqëtarve të cilat i përmbajnë të dhënat e evidentimit të gjyqëtarëve (neni 1, paragrafi (3) të kësaj rregulloreje), raport për ndjekjen e punës të gjyqëtarve dhe gjykatave, mënyra e vlersimit dhe mënyra për listën e kandidatëve për gjyqtarë dhe kryetar të gjykatave.

Neni 4

Kjo rregullore hynë në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nr.01-1157/1

10.07.2020

Shkup

**KËSHILLI GJYQËSOR I
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
Kryetar,
Kire Zdravev**